

ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË SHQIPËRISË PËR NJË ANGAZHIM EFEKTIV ME GREEN CLIMATE FUND (GCF)

Konteksti

Ndikimi i ndryshimeve klimatike në mjedisin e Shqipërisë dhe mirëqënien e banorëve të saj, ka sjellë rritjen e vullnetit politik për të trajtuar ndryshimet klimatike dhe çështjet e lidhura me to. Qeveria e Shqipërisë po përpiqet ta bëjë vendin më rezistent ndaj ndryshimeve klimatike. Objektivi i përgjithshëm i këtij granti ishte të ndihmonte vendin në identifikimin e aktiviteteve të ndryshimeve klimatike me prioritet të lartë financimi, duke mundësuar kështu rritjen e investimeve në fusha të lidhura me klimën. Konkretisht, si rezultat i aktiviteteve, u forcuan kapacitetet institucionale të Pikës Qëndrore Kombëtare (PQK), duke i mundësuar atyre të përmbushin në mënyrë efektive rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me GCF, duke përfshirë ngritjen dhe zbatimin e një procedure mos-kundërshtimi. Nëpërmjet një procesi shumë-palësh angazhimi, projekti realizoi gjithashtu zhvillimin e Programit Kombëtar, duke përfshirë prioritetet e zhvillimit të Shqipërisë në lidhje me GCF-në, në përputhje me strategjitë kombëtare. Projekti ndihmoi gjithashtu në krijimin e një mekanizmi për të lehtësuar komunikimin e nominimeve të subjekteve të sektorit publik dhe privat që kërkojnë akreditim me GCF.



Objektivat e projektit

Objektivat specifikë të projektit ishin:

- Mbështetja e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe PQK në përmbylljen e Programit Kombëtar për angazhimin me GCF;
- Ndërtimi i kapaciteteve të PQK për angazhimin me GCF;
- Udhëzim dhe mbështetje në fushat prioritare strategjike për angazhimin me GCF, duke mundësuar një proces angazhimi shumë-palësh;
- Transferimi i njohurive dhe aftësive të stafi të MTM-së përmes trajnimeve në punë dhe ndërveprimeve të përditshme.

Produktet

- Hulumtim mbi strategjitë e Shqipërisë për klimën, mjedisin, industrinë, bujqësinë, energjinë dhe menaxhimin e mbetjeve të kryer;
- Lista e mekanizmave të identifikuar për lehtësimin e komunikimit të nominimeve për subjektet që kërkojnë akreditim;
- Procedurë mos-kundërshtimi, që përfshin hapat që çdo subjekt i akredituar që synon të marrë fonde nga GCF duhet të ndërmarrë për të paraqitur projekt-propozimet te GCF;
- Udhëzime për mekanizmat, duke përfshirë shabllonet e nevojshme për t'u përdorur nga subjektet që synojnë nominim;
- Programi kombëtar zyrtar, që përfshin Prioritetet e Zhvillimit të Shqipërisë.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Green Climate Fund (GCF)

PARTNERËT:

- GreenWerk
- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)
- UN Environment Programme
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

KOHËZGJATJA:

18/11/2019 - 29/05/2020

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Breth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitet e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

